

## AKT KALIMI KUOTE

Ky Akt Kalimi Kuote (“Akti”) e lidhur sot më datë 31.03.2023 nga dhe midis:

**Z. Genti Daci**, shtetas shqiptar, lindur më 25.06.1972 në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. identifikimi H20625148U, banues në Rr. Perlat Rexhepi, Nd. 1 H. 6, ap. 29, Tiranë, Shqipëri, në vijim referuar si “**Shitësi**”,

Dhe

**BALFIN - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.** (NUIS K72223031K), me seli në adresën: Rruga Papa Gjon Pali II. Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra 1106, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka e cila vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, këtu e në vijim referuar si “**Blerësi**”.

Shitësi dhe Blerësi do të referohen së bashku si “Palët” dhe individualisht si “Pala” ose “secila Palë”.

### PREAMBULA

(A) Tirana Business University është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjit shqiptar, me seli në adresën Rruga e Kavajes, 1023, ish Parku, Tirana, Albania, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS L01801024T, me kapital të regjistruar 1.428.571,00 Lekë, këtu e në vijim referuar si “**Shoqëria**”.

(B) Në datën e këtij Akti, Shitësi zotëron 241.2 kuota me vlerë Lekë 241,200.00 tërësisht të shlyera në Shoqëri, dhe që përfaqësojnë 16.88% gjashtëdhjetë pikë tetëdhjetë e tetë për qind) të kapitalit të regjistruar këtu e në vijim referuar si “**Kuotat**”.

(C) Palët kanë nënshkruar në datë 28 Mars 2023 një Kontrate Huaje me anë të të cilës Shitësi në cilësinë e Huamarrësit ka marrë nga Blerësi në cilësinë e Huadhënësit, një hua në vlerën prej 250,000 Euro (dyqind e pesëdhjetë mijë), për qëllim të blerjes së kuotave që secili prej ish ortakëve z. Enea Janko dhe z. Gjergj Buxhuku zotëronin në Shoqëri (te dyja pjeset bashke perbejne 16.88% te kapitalit).

(D) Shitësi është cesionar i huase se dhënë Shoqërisë nga Ortaket e mëparshëm dhe deri në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, Shitësit i është mbartur e drejta e vlerës së papaguar, e konvertuar nga lekë në euro me kursin mesatar të tre muajve të fundit, e cila sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, është 107,191.00 (njëqind e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) Euro.

(E) Shitësi ka rënë dakord t'i shesë Kuotat Blerësit së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to dhe Blerësi ka rënë dakord të blejë Kuotat nga Shitësi, me të njejtat kushte, dhe në çdo rast në përputhje me kushtet dhe subjekt i kushteve të këtij Akti.

(F) Në përputhje me kushtet dhe subjekt i kushteve të këtij Akti, Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë te Blerësi, Kuotat.

**PËR KËTË ARSYE**, është rënë dakord si më poshtë:

### 1. PËRKUFIZIMET/INTERPRETIMI

1.1 Termat e mëposhtëm kanë kuptimin si më poshtë, përveç rasteve kur konteksti kërkon dhënien e tjetër kuptimi:



**Akti-** do të thotë ky Akt Kalimi Kuote.

**Data e Aktit**– do të thotë data e nënshkrimit të këtij Akti sic është shkruar më poshtë.

## 1.2 Interpretimi

Titujt e të gjitha dispozitave këtu janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndryshojnë, zgjerojnë ose kufizojnë asnjë nga dispozitat e saj.

## 2. QËLLIMI I AKTIT

- 2.1 Në varësi të kushteve të këtij Akti, Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, Kuotat me garanci të plotë dhe të çliruara nga çdo barrë, bashkë me të drejtat dhe detyrimet që lidhen me to.
- 2.2 Objekt i këtij Akti është shitja dhe transferimi i Kuotave nga Shitësi tek Blerësi, së bashku me të drejtat dhe detyrimet e lidhura me to, duke përfshirë kalimin e huasë së ortakëve siç përcaktohet në pikën (D) të Preambulës, që Shitësi ka kundrejt Shoqërisë.

## 3. ÇMIMI I BLERJES SË KUOTËS

- 3.1 Çmimi total i blerjes për Kuotat është 250,000 Euro (dyqind e pesëdhjetë mijë) (“Çmimi i Blerjes”), i cili përfaqëson vlerën e Kuotave dhe cedimin e Huasë që Shitësi ka kundrejt Shoqërisë TBU.
- 3.2 Palët kanë rënë dakord se pagesa e Çmimit të Blerjes do të konsiderohet e kryer nëpërmjet disbursimit të huasë që Blerësi (si Huadhënës) i ka dhënë Shitësit (si Huamarrës) siç përcaktohet në pikën (C) të Preambulës. Për rrjedhojë, me nënshkrimin e këtij Akti në Datën e Aktit, do të konsiderohet e shlyer edhe kjo hua me të njëjtën vlerë me Çmimin e Blerjes.

## 4. TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 4.1 Titulli i pronësisë së Kuotave i transferohet Blerësit nga Shitësi në ditën dhe Datën e Aktit.
- 4.2 Transferimi i Kuotave do të kryhet në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- 4.3 Të drejtat mbi Kuotat do të transferohen tek Blerësi në datën e nënshkrimit Data e Aktit, dhe Kuotat do të shiten dhe blihen së bashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to, duke përfshirë cedimin e huasë së ortakëve siç përcaktohet në pikën (D) të Preambulës, që Shitësi ka kundrejt Shoqërisë.

## 5. ANGAZHIMET

Shitësi dhe Blerësi autorizojnë Administratorin e Shoqërisë për regjistrimin e transferimit të Kuotave në Regjistrin Tregtar nën emrin dhe pronësinë e Blerësit. Palët bien dakord që Administratori i Shoqërisë të depozitojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) këtë Akt si dhe çdo dokument tjetër që mund të jetë i nevojshëm për qëllimin e një regjistrimi të tillë.

## 6. LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Ky Akt dhe marrëdhënia mes Palëve do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

## 7. JURIDIKSIONI

Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga ose lidhet me këtë Akt ose ka të bëjë me zbatimin ose vlefshmërinë e tij do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## 8. TË NDRYSHME

- 8.1 Palët bien dakord që ky Akt të ndryshohet vetëm me shkrim dhe këto ndryshime të nënshkruhen nga Palët ose nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.
- 8.2 Nëse ndonjë dispozitë e këtij Akti është ose bëhet, tërësisht ose pjesërisht, e pavlefshme, joefektive, ose e pazbatueshme, vlefshmëria, efektet dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të Aktit nuk do të preken. Çdo dispozitë e tillë e pavlefshme, joefektive ose e pazbatueshme do të konsiderohet e zëvendësuar me një dispozitë të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme, që i afrohet qëllimit ekonomik të dispozitës së pavlefshme, joefektive ose të pazbatueshme në lidhje me lëndën, shtrirjen, kohën, vendin dhe

fushëveprimin e dispozitës përkatëse. Sa më sipër do të zbatohet mutatis mutandis për çdo boshllëk që mund të gjendet se ekziston në këtë Akt.

## 9. GJUHA DHE KOPJET

Ky akt nënshkruhet në 3 (tre) njësi origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar më 31.03.2023

### BLERËSI



Emri: Edlira Muka

Titulli: Admisnistrator

Në emër të:

**BALFIN – Balkan Finance Investment Group SHPK**



### SHITËSI



Emri: Genti Daci